

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"2200 euro për person, kesh çdo ditë"/ Zbulohet skema si grupet kriminale rekrutojnë shoferët për transportin e emigrantëve ilegalë
ADRESA	https://piranjat.al/investigime/2200-euro-per-person-cash-cdo-dite-zbulohet-skema-si-grupet-inal-i106570
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 10:54:14 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 09:57:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	35e5f11d36407181d7050746ca015b019a8cfa057f63299d90cc287f8e82e2f
TEKSTI	746940af4e7bbf7189889d86ead59a92925b1f087690913a718b0f919a531fac
PAMJA	39830033c7e262f790d57b98631bdc5d518d089e29af304241c9210a9b193c77

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cd8550a4ca7c787e7a5a0ba5a2b2ccb2943799697932c7b58051d52c889d6e54
E MËPARSHMJA	20a7bf672a9f050e6e8f6c3a15566ef39436350c69d5a6697d2f707c2ddad94d
RRËNJJA MERKLE	53474bde5b7511e7be881f3c323a8b9435c3b5b0c682d69d6abb6eee18e3a200
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cd8550a4ca7c787e7a5a0ba5a2b2ccb2943799697932c7b58051d52c889d6e54>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

Fixhi! Ishte
zëvendësuar

me miell në
një sallë
gryqi në ...

detajet
e para

jete
aksidentuar
nga një aut...

një i
plagosur

paraprake, i
plagosuri është
par...

grupet
kriminale

kufijve dhe që
dyskohet se
përfiton shuma
te

lidhur me...

INVESTIGIME

“2200 euro për person, kesh çdo ditë”/ Zbulohet skema si grupet kriminale rekrutojnë shoferët për transportin e emigrantëve ilegalë

Piranjat News Përditësimi i fundit 29 Shtator 2026, 11:57



Një rrjet i organizuar që vepron përtej kufijve dhe që dyskohet se përfiton shuma të konsiderueshme nga trafikimi i emigrantëve të parregullt.

Në një investigim të ri, “**Piranjat News**” kanë ndjekur gjurmët e një skeme të dyshuar të trafikimit të emigrantëve nga vendet e treta drejt Europës, duke arritur deri te personat që pretendojnë se organizojnë transportin dhe sigurojnë kalimin e tyre.

Bisedat e zhvilluara gjatë investigimit zbulojnë mënyrën se si rekrutohen shoferët, tarifat që kërkohen për çdo emigrant dhe kontaktet që, sipas personave të përfshirë në biseda, shërbejnë për koordinimin e lëvizjeve nga Turqia drejt Greqisë dhe më tej.

Mes dëshmive të mbledhura janë edhe komunikimet me dy persona që prezantohen si pjesë e kësaj skeme. Njëri përdor pseudonimin “Beni”, ndërsa tjetri njihet si “Klodi”.

Personi i dytë, i njohur si Klodi, paraqitet si organizator i transportit. Ai merrej me gjetjen e emigrantëve, pagesat dhe kontaktet me grupe në Turqi.

Emigrantët që përmenden vijnë kryesisht nga Siria, Afganistani, Iraku, Bangladeshi dhe vende të tjera aziatike. Sipas informacioneve të grumbulluara, rruga e tyre kalon nga Turqia në Greqi, më pas në Shqipëri dhe drejt kufirit me Malin e Zi, me synim vendet e Bashkimit Evropian.

Më poshtë janë pjesë nga bisedat e zhvilluara me të dy personat.

Biseda me “Benin”

Gazetari: Cfarë nune është. transport “bore” (droë) ano nierëz? Interesohem.

Përgjigja e trafikantit (Beni):
Shkruaj në këtë numër në WhatsApp: +30 697 224 4552.
Thuaj që të dha Beni për shofer. Puna është ilegale me emigrantë sirianë.

Biseda me Klodin

Gazetari: "Si kalon? Mirë? Sa paguan për transportin nga Edirne deri në Selanik? 15 mijë në muaj? A është transport me sirianë apo çfarë pune është?"

Përgjigja e trafikantit (Klodi):
"Puna është transport njerëzish pa dokumente.

Pagesa është 2200 euro për person.

Domethënë:

– 5 persona në makinë → 11 000 euro pagesë për 1 ditë (një rrugë)

– 6 persona në makinë → 12 200 euro në ditë

Nëse përdoret makina jote, pagesa është 3300 euro për person.

Pagesa bëhet çdo ditë cash në dorë. Të gjitha shpenzimet mbulohen në Greqi.

Puna është brenda Greqisë, nuk ka kalime nëpër dogana. Rruga është nga qyteti A në qytetin B, brenda vendit. Nëse je i interesuar të fillosh punë me ne hajde që nesër, më thuaj, kemi punë plotë, njerëzit i gjej unë dhe çunat."

12:10

78%



Beni
online



September 8

Çfarë pune është?
Interesohem.

11:55 ✓✓

Shkruaj në këtë numër në WhatsApp:
+30 697 224 4552
Thuaj që të dha Beni për shofer.
Puna është ilegale me emigrantë sirianë.

12:06



Message



23:45

Signal strength, Wi-Fi, and battery status (72%) icons



Klodi



18 September

Si kalon? Mirë?
Sa merrni për Greqi? 15 mijë në muaj?
A është transport me refugjatë ilegalë?

09:34 ✓✓

19 September

Puna është transport njerëzish pa dokumente.
Pagesa është 2200 euro për person.

Domethënë:

5 persona në makinë → 11 000 euro pagesë
për 1 ditë (një rrugë)

6 persona në makinë → 12 200 euro në ditë

Nëse përdoret makina jote, pagesa është
3300 euro për person.

Pagesa bëhet çdo ditë cash në dorë.

Të gjitha shpenzimet mbulohen në Greqi.

Puna është brenda Greqisë, nuk ka kalime
nëpër dogana.

Rruga është nga qyteti A në qytetin B,
brenda vendit.

Nëse je i interesuar, më thuaj.

23:39



Message



Në Shqipëri, policia ka goditur disa raste të ngjashme gjatë muajit shtator 2026. Në Shkodër u arrestua një 39-vjeçar i cili po transportonte 16 emigrantë (nga Afganistani, Somalia dhe Bangladeshi) drejt kufirit me Malin e Zi. Operacione të tjera janë kryer në zonën e Korçës, Gramshit dhe Sarandës, ku janë kapur shoferë dhe automjete të përdorura për transportin e emigrantëve të paligjshëm.

Sipas informacioneve të grumbulluara, Beni merrej kryesisht me gjetjen e shoferëve, ndërsa Klodi me organizimin e transportit dhe kontaktet me grupet që sillnin emigrantët nga Turqia.

Përfshirja në këtë aktivitet është e paligjshme sipas legjislacionit shqiptar dhe grek. Personat që pranojnë oferta të tilla rrezikojnë arrestim, sekuestrim të mjetit, dënime penale dhe procedime për ndihmë në kalimin e paligjshëm të kufirit.

Autoritetet këshillojnë qytetarët të jenë jashtëzakonisht të kujdesshëm me oferta të tilla, veçanërisht kur premtohen pagesa shumë të larta në cash dhe kur aktiviteti përshkruhet si "ilegal" ose "pa dokumente"./Piranjat News

-Kerkojme shofera ne Greqi

-Pagesa arrin deri ne 5k 🙌🙌





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.